



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socialne Zastite
Ministry of Labour and Social Welfare

31.08.2015, Prishtinë

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke u bazuar në Ligjin nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2015, Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren e MPMS-së Nr. 02/2015 për Kriteret dhe Procedurat e Përkrahjes Financiare për Subvencione dhe Grante, bën ftesë për mbështetje financiare me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat, që zhvillojnë aktivitete në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

FTESE PËR PROPOZIME

Qëllimi dhe objektivat

Mbështetje me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat, për zbatimin e projekteve për zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare. Të gjithë Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) dhe Shoqatat të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtje të fëmijëve, persona me aftësi të kufizuara, persona të moshuar, si dhe ofrimin e mbështetjes së familjeve që jetojnë në varfëri, mund të aplikojnë me projekt propozime për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione nga programet e mirëqenies sociale. Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare, duhet të kanë për objektive zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e këtyre shërbimeve sociale dhe familjare:

- a. *Shërbime rezidenciale për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar dhe neglizhuar;*
- b. *Shërbime alternative dhe këshillime për zhvillimin e strehimit familjar;*
- c. *Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur;*
- d. *Shërbime ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara;*
- e. *Shërbime ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare;*
- f. *Shërbime dhe mbështetje me të mira materiale, për familjet që jetojnë në varfëri dhe kushte të rënda të banimit;*
- g. *Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara;*
- h. *Organizimi i punëtorive për avokim, këshillim, trajnim, sensibilizim si dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme rekreative të personave me aftësi të kufizuara;*
- i. *Shërbime mbështetëse, sensibilizim dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme rekreative për pensionistë dhe persona të moshuar.*

Financimi dhe zbatimi i projekteve

Shuma maksimale e mbështetjes financiare me subvencione, për një OJQ dhe Shoqatë e cila ofron shërbime sipas pikave (a,b,c,d,e) mund të jetë deri në **20,000 euro**, ndërsa shuma maksimale e mbështetjes së një OJQ-je apo Shoqate e cila do të ofrojë shërbime dhe zhvillojë aktivitete sipas pikave (f, g, h, i) mund të jetë deri në **10,000 euro**. Shuma përfundimtare e përkrahjes financiare, do të përcaktohet pas vlerësimit të projekteve nga një komision i themeluar nga MPMS-ja. Së paku 80% e aktiviteteve në kuadër të projekt propozimit dhe mbështetjes financiare të aprovuar duhet të realizohet gjatë vitit 2015. Kohëzgjatja për zbatimin e aktiviteteve të projekt propozimit do të jetë minimum një (1) deri në katër (4) muaj.

Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

OJQ-të dhe Shoqatat në projekt propozimet e tyre, ju lejohet të përfshijnë kostot për: shpenzimet e pagave të stafit, pagesës së ekspertëve të angazhuar, mbulimin e shpenzimeve të komunalive dhe disa shpenzimeve tjera operative për zbatimin e aktiviteteve dhe ofrimin e shërbimeve sipas projekt propozimit. Shuma maksimale e shpenzimeve të pranueshme për paga të stafit, duke përfshirë edhe pagesën e ekspertëve në kuadër të një projekti, nuk mund të jetë më e lartë se 50% e vlerës së mbështetjes financiare të aprovuar për subvencione nga ana e komisionit të MPMS-së. OJQ-të dhe Shoqatat në projekt propozimet e tyre nuk duhet të përfshijnë kostot e shpenzimeve për investime kapitale, blerje të inventarit apo pajisjeve të zyrës nga mbështetja e kërkuar për subvencione në MPMS.

Kualifikimi dhe dokumentet për aplikim

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat kërkojnë mbështetje me subvencione, duhet të janë të regjistruara sipas legjisllacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, ndërsa për ofrimin e shërbimeve sociale sipas pikave (a,b,c,d,e) duhet të janë edhe të licencuara nga MPMS-ja. OJQ-të dhe Shoqatat duhet të ofrojnë dëshmi për projektet e realizuara në të kaluarën dhe kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare. Në projekt propozime duhet të përshkruhet qartë qëllimi, objektivat, aktivitetet, përfutuesit dhe buxheti. Përshkrimi i kapaciteteve menaxhuese të organizatës, personelit dhe përfshirja e eksperteve në zbatimin e aktiviteteve të projektit, gjithashtu edhe kontributi i donatorëve tjerë nëse marrin pjesë në financim të projektit duhet të përfshihet në kuadër të projekt propozimit. OJQ-të dhe Shoqatat përveç dëshmimeve dhe kushteve për kualifikim, duhet të plotësojnë dhe bashkëngjisin këto dokumente për aplikim:

- Forma e aplikimit;
- Formulari për projekt propozim;
- Tabela e buxhetit të projekt propozimit;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së apo Shoqatës;
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
- Kopja e statutit të themelimit të OJQ-së apo Shoqatës;
- Kopja e xhirollogarisë së OJQ-së apo Shoqatës;
- Kopja e letërnjoftimit të Drejtorit Ekzekutiv të OJQ-së apo Shoqatës;
- Kopja e letërnjoftimit të Menaxherit apo Koordinatorit të Projektit;
- Kopja e licencës për OJQ-të dhe Shoqatat e licencuara nga MPMS-ja;
- CV-të e ekspertëve dhe stafit të angazhuar në zbatimin e projektit.

OJQ-ët dhe Shoqatat të cilat kanë marrë mbështetje me subvencione nga MPMS-ja, për zbatimin e projekteve gjatë këtij viti nuk kanë të drejtë aplikimi në këtë thirrje publike.

Afati dhe procedura e aplikimit

Afati për përgatitjen e projekt propozimeve për mbështetje me subvencione do të jetë i hapur dhjetë (10) ditë pune nga data e shpalljes në mediat e shkruara dhe elektronike. Projekt propozimet me dokumentet e bashkangjitura, duhet të dorëzohen: një (1) origjinal dhe dy (2) kopje në gjuhën shqipe. Me rastin e dorëzimit të projekt propozimit, duhet të plotësoni dhe pranoni formën e aplikimit si dëshmi për dorëzimin e aplikacionit në Zyrën e Arkivit në MPMS.

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në çdo ditë pune nga ora **8.00-16.00**, nga data **31 gusht 2015** deri më **11 shtator 2015**. Formën e aplikimit dhe formularin për projekt propozime, mund të shkarkoni nga ueb faqja zyrtare e MPMS-së (www.mpms.rks-gov.net)

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Zyra e Arkivit në MPMS
Kati IV, Zyra Nr. 304
Rruga UÇK-së, Nr. 1
10 000 Prishtinë